



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE**  
**KRIMIN E ORGANIZUAR**

---

**LETRA E TE DREJTAVE TË TË VIKTIMËS (TË DËMTUARIT NGA VEPRRA PENALE)**

Në bazë të parashikimeve të neneve 137,140, pika 1 dhe 58, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, dërgohet bashkë me njoftimin për seancën paraprake “Letra e të drejtave” e viktimës gjatë procesit penal.

Neni 58, pika 1 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

**Të drejtat e viktimës së veprës penale**

*1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:*

*a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;*

*b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;*

*c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;*

*ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;*

*d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;*

*dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;*

*e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimën e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;*

*ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;*

*f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;*

*g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;*

*gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale*

*h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;*

*i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;*

*j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.*

*Shënim: Ky akt i bashkëlidhet të gjitha akteve të njoftimit drejtuar marrësit.*